VENDIM
Nr. 271, datë 7.5.2014

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", dhe të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të shkronjës "a", të pikës 1/3, shtohet emërtesa "Inspektorati Shtetëror Shëndetësor".

2. Pika 4/6 riformulohet si më poshtë vijon:

4/6. Në Agjencinë e Prokurimit Publik, nëpunësit në pozicionin "titullar institucioni", "drejtor drejtorie" "përgjegjës sektori" dhe "specialist" në drejtoritë dhe sektorët teknikë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.".

3. Në lidhjen nr. 9, që përmendet në pikën 13, shtohen këto emërtesa:

a) "Inspektor në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor, në nivel rajonal, inspektor në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave dhe specialist në zyrën vendore të Shërbimit të Provës, kategoria IV-b.".

b) "Specialist në zyrën vendore të Shërbimit të Provës, kategoria IV-c.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe për Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor i shtrin efektet financiare nga momenti i emërimit të nëpunësve.

KRYEMINISTRI
Edi Rama